

Këshilli i Sigurisë në
Shqipëri mbledhet
pas rastit Hyseni:
Të respektohen hetimet

FACE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS MIRATON DEKLARATËN NË MBROJTJE TË UÇK-së DHE LIDERËVE TË SAJ

FACE 4



Kuvendi i Kosovës, me 99 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e ka miratuar deklaratën për aktgjykimin e Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Deklarata e iniciuar nga Partia

Demokratike e Kosovës (PDK) u harmonizua me të gjitha grupet parlamentare shqiptare. Në deklaratë Kuvendi shpreh shqetësimin e thellë për aktgjykimin e shkallës së parë dhe për mungesën e transparencës dhe shkellen e standardeve të gjyqimit të

drejtë. Përmes kësaj deklarate kërkohet nga të gjitha institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës që t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për mbrojtjen e së vërtetës dhe të pastërtisë së luftës çlirimtare të popullit të Kosovës

PARTITË PA MARRËVESHJE PËR PRESIDENTIN E RI, AFATI PO SOSET

F. 5



KINA MERR TIMONIN NË TREGUN E VETURAVE ELEKTRIKE NË KOSOVË

F. 3



ASK-ja PUBLIKON TË DHËNAT PËR EMETIMET NË AJËR: SEKTORI ENERGJETIK SHKAKTON 82.8 % TË CO₂

F. 8

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SPORT



KOSOVA NDALET NË VJENË NGA AUSTRIA. TANI FOKUSI TË SFIDA E RADHËS NDAJ IZRAELIT

F. 11

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BRUKSELI IA KUJTON SERBISË NEVOJËN PËR ZBATIMIN E SANKSIONEVE TË BE-së NDAJ RUSISË PAS BISEDËS VUÇIQ - PUTIN

BRUKSEL, 28 SHTATOR - Një ditë pasi presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, e zhvilloi një bisedë telefonike me presidentin rus Vladimir Putin, Komisioni Evropian ia ka kujtuar Beogradit se duhet t'i përshatë më shumë politikën e tij me ato të Bashkimit Evropian, përfshirë zbatimin e sanksioneve ndaj Rusisë për shkak të luftës në Ukrainë. "Si vend kandidat, nga Serbia pritet që politikën e saj t'i harmonizojë me objektivat e BE-së, përfshirë politikën energjetike dhe atë të jashtme, dhe të jetë partnerë e besueshme që ndjek të njëjtin drejtim strategjik", tha për Radion Evropa e Lirë zëdhënësi i Komisionit Evropian, Guillaume Mercier.

Ai tha se qëndrimi i BE-së ndaj marrëdhënieve të vendeve kandidatë me Rusinë është "gjithmonë plotësisht i qartë". "Marrëdhëniet me Rusinë nuk mund të zhvillohen sikur gjithçka të ishte si më parë me regjimin e Putinit, dhe kjo në hijen e luftës agresore, të paprovokuar dhe të pajustificuar të Rusisë kundër Ukrainës", tha Mercier.

Deklaratat e tij pasuan bisedën telefonike të 26 shtatorit mes Vuçiqit dhe Putinit.

Biseda u zhvillua një ditë para se Vuçiqi të jepte dorëheqje nga posti i presidentit të Serbisë, pasi është bartës i listës së Partisë Përparimtare Serbe

(SNS) për postin e kryeministrit në zgjedhjet e parakohshme të 25 tetorit.

Pas bisedës me Putinin, Vuçiq tha se beson se marrëveshja për furnizimin e Serbisë me gaz rus do të zgjatet.

Marrëveshja e tanishme afatshkurtër skadon më 30 shtator.

Serbia importon nga Rusia më shumë se 80 për qind të gazit që konsumon.

Beogradi nuk ka arritur marrëveshje afatgjatë për furnizimin me gaz që nga skadimi i kontratës së mëparshme trevjeçare, në verën e vitit 2025. Që atëherë, marrëveshjet me Moskën janë zgjatuar për periudha të shkurtra.

Marrëveshja e tanishme u zgjat në qershor për tre muaj.

Komisioni Evropian tha se është në dijeni të bisedës mes Vuçiqit dhe Putinit.

Duke iu referuar deklaratës së Vuçiqit se presidenti i ardhshëm i Serbisë do të duhet të kujdeset për interesat e vendit dhe ta ruajë një baraspeshë në raport me aktorët e rëndësishëm të politikës ndërkombëtare, Mercier rikujtoi detyrimet që Serbia i ka si vend kandidat për anëtarësim në BE.

Sipas tij, vendimi i Serbisë për të aplikuar për anëtarësim nënkupton zotimin për t'i harmonizuar politikën e saj me BE-në, përfshirë politikën e jashtme



dhe të sigurisë.

"Përputhshmëria e Serbisë me politikën tonë të përbashkët të jashtme dhe të sigurisë vazhdon të jetë dukshëm më e ulët sesa te vendet e tjera kandidatë në Ballkanin Perëndimor", tha Mercier.

Ai shtoi se Serbia duhet, si prioritet, t'i shtojë përpjekjet për një nivel "më të qëndrueshëm dhe dukshëm më të lartë" të harmonizimit me politikën e BE-së, përfshirë sanksionet ndaj Rusisë.

"Duam të jemi në gjendje të llogarisim në Serbinë si partnerë e besueshme", tha ai.

Komisioni Evropian tha se BE-ja po e rrit mbështetjen për

vendet e Ballkanit Perëndimor në fushën e sigurisë energjetike, me synim uljen e varësisë nga lëndët djegëse fosile dhe diversifikimin e burimeve dhe rrugëve të furnizimit.

Sipas Mercier, kjo do t'u mundësonte vendeve të rajonit integrim më të mirë të rrjeteve energjetike dhe qasje në energji nga burime të ndryshme.

"Pas fillimit të luftës agresore të Rusisë kundër Ukrainës, pamë se sa e rëndësishme është kjo dhe çfarë problemesh mund të shkaktojë për çdo vend evropian, përfshirë Serbinë", tha ai.

BE-ja synon që deri në fund të vitit të ardhshëm të ndërpresë

gradualisht dhe në mënyrë efektive importin e gazit dhe naftës ruse, ndërsa nga vendet kandidatë pret që t'i përshtatin politikën e tyre me këtë objektiv.

Negociatat e Serbisë për anëtarësim në BE kanë ngecur, ndër të tjera, edhe për shkak se ajo nuk e ka përshtatur mjaftueshëm politikën e saj të jashtme me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së.

Serbia nuk u është bashkuar sanksioneve të BE-së kundër Rusisë pas pushtimit të Ukrainës.

Niveli i saj i përputhshmërisë me politikën e sanksioneve të BE-së është rreth 60 për qind.

KËSHILLI I SIGURISË NË SHQIPËRI MBLIDHET PAS RASTIT HYSENI: TË RESPEKTOHEN HETIMET

TI RANË, 28 SHTATOR - Këshilli i Sigurisë Kombëtare i Shqipërisë u bëri thirrje të hënën institucioneve që t'i respektojnë hetimet e pavarura të drejtësisë pas vendimit për arrest shtëpiak ndaj ish-drejtoreshës së shërbimit inteligjent, Vlora Hyseni, nën dyshimet për zbulim të sekreteve shtetërore. "Hetimet e drejtësisë të zhvillohen tërësisht të pavarura dhe të respektohen nga të gjithë. Çështjet individuale të mos kthehen në krizë besimi ndaj shtetit dhe ndaj institucioneve të sigurisë", tha Presidenca e Shqipërisë pas mbledhjes së Këshillit.

Mbledhja, e cila zgjati rreth 90 minuta të hënën, u thirr nga presidenti Bajram Begaj për të diskutuar për zhvillimet e fundit dhe ndikimin e tyre në institucionet e sigurisë.

Në njoftimin e Presidencës nuk përmendet me emër Hyseni, por mbledhja u zhvillua ndërsa ish-shëfja e Shërbimit Informativ të Shtetit (ShISH) po hetohet nga Prokuroria e Posaçme (SPAK).

Këshilli tha se institucionet e



sigurisë nuk duhet të konkurrojnë me njëra-tjetrën dhe se mosbesimi institucional duhet të zëvendësohet me bashkëpunim, koordinim dhe komunikim profesional.

"Shqipëria ka institucione, ka partnerë dhe aleatë ndërkombëtarë, ka profesionistë dhe kapacitete", tha Presidenca, duke u bërë thirrje institucioneve

të punojnë së bashku për ta forcuar shtetin, sigurinë kombëtare dhe besimin e qytetarëve.

Në mbledhje morën pjesë kryeministri Edi Rama, kryetari i Kuvendit Niko Peleshi, ministri i Mbrojtjes, i Punëve të Brendshme dhe i Punëve të Jashtme, drejtori i Policisë së Shtetit dhe drejtues të tjerë të

institucioneve të sigurisë dhe mbrojtjes.

ShISH-i u përfaqësua nga Elvis Lila, drejtor i Departamentit Operativ, të cilit i janë deleguar përkohësisht kompetencat administrative të drejtorit të institucionit.

Në mbledhje u ftuan edhe përfaqësues të SPAK-ut dhe të Prokurorisë së Përgjithshme, tha Presidenca.

Rama, i cili një ditë më parë kishte njoftuar për mbledhjen, tha se Këshilli ishte vendi i duhur për të diskutuar përgjegjësitë institucionale dhe garancitë që duhet të mbrojnë institucionet e sigurisë kur drejtuesit ose punonjësit e tyre bëhen subjekt i një hetimi penal.

"Kur puna e hetimit ngjitet deri te kreu i shërbimit inteligjent të vendit, atëherë ky nuk është më problemi i një pushteti të pavarur. Ky është një problem i krejt shtetit", tha Rama.

Ai e ka cilësuar gjithashtu si "ekstreme" masën e arrestit shtëpiak ndaj Hysenit.

Më 24 shtator Gjykata e Posaçme

la në fuqi masën e arrestit shtëpiak ndaj Hysenit, e cila dyshohet për zbulim të të dhënave sekrete dhe përkrahje të autorit të krimit në kuadër të hetimeve për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

Më 22 shtator Rama njoftoi shkarkimin e Hysenit.

Prokurorët dyshojnë se Hyseni i ka dhënë informacione Ergys Agasit, një prej personave të akuzuar në dosjen "AKSHI", që lidhet me dyshime për manipulim të tenderëve shtetërorë.

Hyseni drejtoi ShISH-in nga viti 2023. Më herët ajo kishte shërbyer zëvendës drejtoreshë e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI), nga ku u shkarkua në vitin 2021 nga presidentja e atëhershme e Kosovës, Vjosa Osmani, dhe kryeministri Albin Kurti.

Këshilli i Sigurimit Kombëtar është organ këshillimor i presidentit të Shqipërisë që shqyrton çështje të sigurisë, mbrojtjes kombëtare dhe koordinimit ndërinstitucional.

KINA MERR TIMONIN NË TREGUN E VETURAVE ELEKTRIKE NË KOSOVË



PRISHTINË, 28 SHTATOR - Nga 780 vetura elektrike të importuara në Kosovë gjatë tetë muajve të parë të këtij viti, 665 erdhën nga një shtet i vetëm: Kina. Katër vjet më parë, nga Kina ishin importuar vetëm 13 vetura elektrike. Brenda kësaj periudhe jo vetëm që është shumëfishuar numri i veturave elektrike që hyjnë në Kosovë, por ka ndryshuar edhe prejardhja e tyre: Gjermania ka humbur primatin, ndërsa Kina është bërë burimi kryesor. Sipas të dhënave të Doganës së Kosovës, nga janari deri në gusht të vitit 2026 janë importuar 780 vetura elektrike - 615 më shumë sesa gjatë gjithë vitit 2022.

Nga Gjermania drejt Kinës

Ndryshimi është edhe më i dukshëm kur shihet prejardhja e veturave. Në vitin 2022 Gjermania ishte burimi kryesor i veturave elektrike që importoheshin në Kosovë. Atë vit prej saj erdhën 49 të tilla, ndërsa nga Kina vetëm 13. Katër vjet më vonë, raporti ka ndryshuar rrënjësisht. Në sasi më të vogla, vetura elektrike importohen edhe nga vende të tjera. Rritja e numrit të veturave elektrike reflektohet edhe në shumën e parave që shpenzohen për to. Vetëm gjatë tetë muajve të parë të këtij viti vlera e veturave elektrike të importuara arriti në mbi 11.5 milionë euro - rreth gjysmë milioni euro më shumë sesa gjatë gjithë vitit 2025. Krahësuar me vitin 2022, vlera e importeve është më shumë se e dyfishuar.

Të përdorurat tejkalojnë të rejat

Një tjetër ndryshim po ndodh edhe brenda vetë tregut të veturave elektrike. Në vitin 2022 pothuajse nëntë në dhjetë vetura elektrike të importuara ishin të reja: 145 të reja kundrejt vetëm 20 të përdorurave. Katër vjet më vonë, trendi është përmbysur.

Pse po rritet interesimi?

Onufër Berisha, shitës i veturave elektrike në kompaninë EVM në Kosovë, thotë se interesimi i qytetarëve është rritur veçanërisht për modelet e prodhuesit kinez BYD. Sipas tij, një nga arsyt kryesore është kostoja e përdorimit. “Qytetarët janë shumë të interesuar, sidomos kur merret parasysh kostoja e mirëmbajtjes dhe operimit. Janë shumë më të lira sesa ato me motor me djegie të brendshme. Është një model i BYD-it që kërkohet shumë. Gjatë natës, me tarifën e lirë, mbushet me energji për rreth tri euro, ndërsa gjatë ditës për rreth gjashtë euro, dhe me një mbushje mund të kalojë më shumë se 400 kilometra”, thotë Berisha për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, edhe shpenzimet e mirëmbajtjes dhe servisimit janë më të ulëta. Të dhënat e Kosovës nuk tregojnë se pse importuesit po orientohen gjithnjë e më shumë drejt Kinës. Por, rritja po ndodh në kohën kur prodhuesit kinezë kanë fituar avantazh në koston e prodhimit të veturave elektrike. Agjencia Ndërkombëtare e

Energjisë (IEA) thotë se çmimet e baterive ranë më shpejt në Kinë sesa në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara gjatë vitit 2024. Sipas saj, konkurrenca e fortë, rritja e efikasitetit të prodhimit dhe integrimi i zinxhirit të furnizimit kanë ndihmuar në uljen më të shpejtë të kostove në Kinë dhe në rritjen e avantazhit konkurrues të prodhuesve kinezë të veturave elektrike dhe baterive. IEA vlerëson se, në vitin 2024, afër dy të tretat e veturave elektrike me bateri të shitura në Kinë kushtonin më pak se modelet ekuivalente me motorë me djegie të brendshme. E prania në rritje e prodhuesve kinezë nuk është karakteristikë vetëm e tregut të Kosovës. Në vitin 2025 veturat e prodhuara në Kinë përbënin 20 për qind të shitjeve të veturave plotësisht elektrike në Bashkimin Evropian, sipas të dhënave të Shoqatës Evropiane të Prodhuesve të Automjeteve (ACEA). Rritja vazhdoi pavarësisht se BE-ja, në fund të vitit 2024, vendosi tarifa shtesë prej 7.8 deri në 35.3 për qind për veturat elektrike të prodhuara në Kinë. Për prodhuesin kinez BYD, tarifa u caktua në 17 për qind. Bizneset në Kosovë që i përdorin veturat elektrike çdo ditë thonë se llogaria është kryesisht ekonomike. Halil Elshani, pronar i kompanisë “El-Taxi”, thotë se kompania e tij ka 40 vetura elektrike - prodhim francez - në operim. Ai përmend si arsye koston më të ulët të përdorimit, por edhe ndikimin më të vogël në mjedis. “Janë më të favorshme për shkak të çmimit të energjisë elektrike. Edhe pse ka pasur ngritje të tarifave të energjisë, krahasuar me çmimin

e karburanteve, janë më të leverdishme. E sidomos tash, kur ka lëvizje të çmimeve të karburanteve”, thotë Elshani për Radion Evropa e Lirë.

Rritje e shpejtë, por ende pjesë e vogël e tregut

Shifrat e rritjes janë të mëdha, por baza mbetet e vogël. Përballë 780 veturave elektrike të importuara nga janari deri në gusht, në Kosovë hynë mbi 25 mijë vetura gjithsej gjatë së njëjtës periudhë. Vlera e veturave elektrike ishte rreth 11.5 milionë euro, ndërsa vlera e përgjithshme e automjeteve të importuara arriti në mbi 309 milionë euro. Në tregun e përgjithshëm, Gjermania vazhdon të jetë bindshëm burimi kryesor i veturave. Por, edhe këtu vihet re një rritje e importeve nga Kina.

Elektrike apo me karburant, taksat mbeten të njëjta

Megjithëse Kosova synon ta rrisë numrin e veturave elektrike, aktualisht ato nuk trajtohen më favorshëm në import sesa veturat me benzinë apo naftë. Për veturat e importuara zbatohet taksa doganore prej 10-përqindësh dhe TVSh-ja prej 18-përqindësh. Për veturat e përdorura aplikohet edhe akciza, e cila, varësisht nga vjetërsia, shkon nga 400 deri në 700 euro. Vetëm për 780 veturat elektrike të importuara nga janari deri në gusht të këtij viti janë paguar rreth 1.2 milion euro taksa

doganore. Për më shumë se 25 mijë vetura të importuara gjithsej gjatë së njëjtës periudhë janë paguar mbi 25 milionë euro taksa doganore. Oda Ekonomike e Kosovës ka kërkuar nga qeveria ta heqë taksën doganore për veturat elektrike dhe ta ulë TVSh-në nga 18 në 8 për qind. Sipas Odës, masa të tilla do t'i nxisnin qytetarët dhe kompanitë të investonin në automjete elektrike dhe, në këtë mënyrë, të kontribuonin në mbrojtjen e mjedisit. Veturat me motorë me djegie të brendshme, që përdorin benzinë apo naftë, lirojnë gjatë përdorimit dyoksid karboni dhe ndotës të tjerë të ajrit. Nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Infrastrukturës nuk iu përgjigjën pyetjeve të Radios Evropa e Lirë nëse është shqyrtuar kërkesa e Odës dhe nëse parashihihen subvencione apo lehtësime të tjera për blerjen e veturave elektrike. Strategjia e Energjisë 2022-2031 parashih që deri në vitin 2031 numri i veturave elektrike në Kosovë të arrijë në rreth 15 mijë. Kryeministri Albin Kurti ka paralajmëruar një ndryshim që prek një pjesë tjetër të tregut të automjeteve. “Për veturat e importuara nga Bashkimi Evropian do të hiqet taksa doganore prej 10-përqindësh”, ka thënë Kurti më 13 shtator gjatë prezantimit të programit qeveritar. Nëse kjo masë zbatohet vetëm për automjetet që përfitojnë sipas rregullave përkatëse të originës nga BE-ja, ajo mund të krijojë një dallim të ri në një treg që tashmë po ndryshon shpejt.



KUVENDI I KOSOVËS MIRATON DEKLARATËN NË MBROJTJE TË UÇK-së DHE LIDERËVE TË SAJ

Kuvendi i Kosovës, me 99 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, e ka miratuar deklaratën për aktgjykimin e Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Deklarata e iniciuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) u harmonizua me të gjitha grupet parlamentare shqiptare. Në deklaratë Kuvendi shpreh shqetësimin e thellë për aktgjykimin e shkallës së parë dhe për mungesën e transparencës dhe shkeljen e standardeve të gjyimit të drejtë. Përmes kësaj deklarate kërkohet nga të gjitha institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës që t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për mbrojtjen e së vërtetës dhe të pastërtisë së luftës çlirimtare të popullit të Kosovës

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Kuvendi i Kosovës ka miratuar me 99 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim Deklaratën lidhur me aktgjykimin e Dhomave të Specializuara ndaj ish-krerëve të UÇK-së.

Deklarata e propozuar përmban shtatë pika dhe shpreh shqetësimin e Kuvendit lidhur me aktgjykimin ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Përmes kësaj deklarate kërkohet nga të gjitha institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës që t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për mbrojtjen e së vërtetës dhe të pastërtisë së luftës çlirimtare të popullit të Kosovës. "Kuvendi bën thirrje për hartimin e një strategjie të përbashkët shtetërore, në kuadër të së cilës të bashkërendohen veprimet juridike, institucionale dhe diplomatike për mbrojtjen dhe afirmimin e së vërtetës së plotë historike mbi luftën e drejtë për

liri dhe çlirim të Kosovës", theksohet në deklaratë.

Kuvendi, gjithashtu, përmes kësaj deklarate kundërshton çdo përpjekje për ta përmbysur të vërtetën historike të Kosovës, për të vënë në dyshim luftën e saj çlirimtare apo për ta barazuar popullin që luftoi për liri dhe mbijetesë me regjimin që e shtypi atë.

Kryeparlamentarja Albulena Haxhiu ka thënë se sot Kuvendi i Kosovës foli me një zë lidhur me Deklaratën për Aktgjykimin e Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

Haxhiu ka thënë se do të qëndrojnë bashkë në këtë betejë deri në lirin e plotë të ish-krerëve të UÇK-së. "Lufta e popullit tonë për liri dhe pavarësi, përmes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ishte një luftë e drejtë. Ajo lindi si përgjigje ndaj represionit dhe krimeve të rënda të Serbisë, në një kohë kur populli ynë vritej, dëbohej dhe përndiqej nga shtetëpitë e veta. Kjo e vërtetë nuk

zhbëhet me asnjë aktgjykim. Institucionet e Republikës së Kosovës duhet të veprojnë të bashkuara, përmes një strategjie të përbashkët juridike dhe diplomatike, për të mbrojtur të vërtetën dhe për të paraqitur drejtësisht para botës luftën e popullit tonë për liri. Rruga drejt drejtësisë vazhdon përmes procesit të apelit. Ne do të qëndrojmë bashkë në këtë betejë, deri në lirin e plotë të ish-krerëve të UÇK-së", ka thënë Haxhiu.

PDK-ja falënderon deputetët për miratimin e deklaratës në mbrojtje të UÇK-së: Tani është radha e votimit të ndryshimeve në Ligjin për Dhomat e Specializuara

Partia Demokratike e Kosovës ka përshëndetur miratimin nga Kuvendi të deklaratës për aktgjykimin e Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj

Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

Partia Demokratike e Kosovës i ka falënderuar të gjitha grupet parlamentare për mbështetjen dhe kontributin në harmonizimin e tekstit të deklaratës së propozuar nga grupi ynë parlamentar. "Sot Kuvendi shprehu qëndrimin e tij për mbrojtjen e së vërtetës së luftës çlirimtare dhe kundërshtimin e aktgjyimit që e vlerëson të padrejtë. Ky është një hap i rëndësishëm i vullnetit të përbashkët politik. Tani ai vullnet duhet të kthehet në veprim konkret. Radha është e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara, të propozuar nga PDK. Kërkojmë nga Qeveria që ta procedojë pa vonesë në Kuvend dhe nga të gjitha grupet parlamentare që ta trajtojnë e votojnë me urgjencë. Deklarata shpreh qëndrimin e Kuvendit. Votimi i ligjit është hapi i radhës për t'i dhënë përgjigje institucionale kërkesave që kemi ngritur. PDK

do të vazhdojë të angazhohet për mbrojtjen e luftës së drejtë të UÇK-së dhe për një proces të drejtë ndaj ish-krerëve të saj. Sot u dëshmuva se mund të ndërtohet vullneti i përbashkët për mbrojtjen e vlerave tona. Tani kërkojmë që i njëjti vullnet të dëshmohej edhe në votimin e ligjit", është thënë në komunikatën e PDK-së.

Deklaratë për aktgjykimin e Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit

Kuvendi i Republikës së Kosovës, si institucioni përfaqësues i qytetarëve dhe shprehje e vullnetit të tyre demokratik, në seancën plenare të mbajtur më 28.09.2026; Duke kujtuar se liria dhe pavarësia e Kosovës janë fryt i

PARTITË PA MARRËVESHJE PËR PRESIDENTIN E RI, AFATI PO SOSET

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Partitë parlamentare ende nuk janë përcaktuar për një emër të cilin do ta mbështesnin për president të ardhshëm të Kosovës pavarësisht se një afat kushtetues për zgjedhjen e presidentit mbaron kah fundi i javës së ardhshme. Në një aktgjykim të 23 shtatorit, Gjykata Kushtetuese e Kosovës sqaroi se afati 60-ditor për zgjedhjen e presidentit ka nisur më 8 gusht, nga dita kur u konstituua Kuvendi, dhe përfundon më 6 tetor. Për këtë çështje kryetari i Partisë Demokratike e Kosovës (PDK), Bedri Hamza, bisedoi të dielën me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti. Hamza u tha të hënën gazetarëve

se në atë takim ku u shtjelluan edhe tema të tjera të situatës politike, biseduan për çështjen e presidentit pa folur rreth emrave konkretë për këtë pozitë. Ai tha se partia e tij është e gatshme të diskutojë më tutje për çështjen e presidentit me Lëvizjen Vetëvendosje, nëse miratohet projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë. "Nuk kemi shkuar për emrat, nuk i kemi folur. Nëse kalohet ligji jemi të hapur edhe për tema të tjera", tha ai. Për momentin ky projektligj është në qeveri, tek e cila është dërguar për një mendim më 25 shtator. Që nga 4 prilli Kosova është me ushtrues detyre të presidentit. Ky

funksion, sipas Kushtetutës, nuk mund të ushtrohet më shumë se gjashtë muaj nga ushtruesi i detyrës. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) është shprehur e gatshme për të kontribuar në zgjidhjen e çështjes së presidentit. Shefja e grupit parlamentar e LDK-së, Jehona Lushaku, tha se partia opozitare ka vullnet për t'i konkretizuar hapat që të zgjidhet secili problem në mënyrë që të funksionojnë të gjitha institucionet. "Ne nuk jemi në situatë që mund të themi që jemi për ose kundër një kandidati, por jemi të gatshëm të kontribuojmë për zgjedhjen e presidentit", tha ajo. Pas bisedimeve në mes të LV-së dhe LDK-së së Lumir Abdixhikut,

palët arritën një marrëveshje në fund të gushtit për një president konsensual, dhe dy partitë propozuan Bekim Sejdiun. Megjithatë, një ditë pas njoftimit për marrëveshjen, u bë me dije se gjashtë deputetë të LDK-së nuk e përkrahnin këtë kandidaturë - duke bërë që, në praktikë, Sejdiu të mos kishte 81 votat e nevojshme - dy të tretat e Kuvendit me 120 ulëse, që kërkohen për procesin e zgjedhjes së presidentit. Si pasojë, më 14 shtator Sejdiu u tërhoq nga kandidatura për president për shkak të mbështetjes së pamjaftueshme për zgjedhjen e tij. Aleanca, e cila përfaqësohet me shtatë deputetë në Kuvend, ka refuzuar të takohet me liderin e

LV-së, Albin Kurti, rreth çështjes së presidentit, teksa kishte paraqitur gjashtë kushte në këmbim të mbështetjes. Deputeti i kësaj partie, Ramush Haradinaj, tha se Kurti "është tallur" me liderët opozitarë në këto takime pasi, sipas tij, qëllimi ka qenë shkuarja në zgjedhje. "I ka ftuar në takime, i ka tallur dhe në fund i ka lënë pa marrëveshje", është shprehur Haradinaj para medieve të hënën, duke shtuar se Aleanca "nuk bëhet pjesë e lojërave të Kurtit". Kosova rrezikon të shkojë drejt zgjedhjeve të reja - që do të ishin të katërtat që nga shkurti i vitit 2025 - nëse partitë nuk gjejnë ujdi që ta zgjedhin kreun e ri të shtetit para afatit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese.



një përpjekje të gjatë për dinjitet njerëzor, barazi dhe të drejtën e një populli për të vendosur vetë për të ardhmen e tij; Duke rikujtuar se lufta e popullit për liri dhe pavarësi përmes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës lindi në rrethanat e represionit sistematik dhe krimeve gjenocidale të Serbisë, kur popullit të Kosovës po i mohoheshin të drejtat themelore dhe vetë mundësia për të jetuar i lirë në vendin e tij; Duke njohur rëndësinë vendimtare të ndërhyrjes së NATO-s për ndalimin e dhunës ndaj popullit të Kosovës dhe për çlirimin e vendit. Duke theksuar se asnjë aktgjykim nuk mund ta zhbëjë të vërtetën historike të luftës në Kosovë. Serbia ushtroi gjenocid e krime kundër njerëzimit; zhvilloi një fushatë të egër terrori dhe spastrimi etnik në

Kosovë; masakroi civilë të pafajshëm, vrau fëmijë, gra e të moshuar, dhunë seksuale si armë lufte, dëboi me forcë popullsinë dhe dogji e shkatërroi fshatra e qytete të tëra. Këto krime ishin sistematike, pasojat e të cilave rëndojnë edhe sot mbi mijëra familje. I bindur se respektimi i shtetit të së drejtës përfshin edhe të drejtën dhe përgjegjësinë për të kundërshtuar, me mjete ligjore dhe institucionale, një aktgjykim që vlerësohet i padrejtë; Liria dhe pavarësia e Kosovës janë të lidhura ngushtë me sakrificën e brezave, me rezistencën politike dhe paqësore të udhëhequr nga Presidenti Ibrahim Rugova, me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe me mbështetjen vendimtare të aleatëve tanë perëndimorë, përfshirë NATO-n.

Miraton këtë deklaratë:

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës, si institucioni përfaqësues i qytetarëve dhe shprehje e vullnetit të tyre demokratik, shpreh shqetësimin e tij të thellë ndaj aktgjykimit të shkallës së parë kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.
2. Konsideron si të papranueshëm përfundimin për ekzistencën e një qëllimi kriminal të përbashkët.
3. KËRKON nga të gjitha institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për mbrojtjen e së vërtetës dhe të pastërtisë së luftës çlirimtare të popullit të Kosovës. Kuvendi bën thirrje për hartimin e një strategjie të përbashkët shtetërore, në

kuadër të së cilës të bashkërendohen veprimet juridike, institucionale dhe diplomatike për mbrojtjen dhe afirmimin e së vërtetës së plotë historike mbi luftën e drejtë për liri dhe çlirim të Kosovës. 4. Në Kosovën e viteve 1998 - 1999, ekzistenca e një ndërmarrje të përbashkët kriminale për dëbimin e shqiptarëve nga Kosova është vërtetuar tashmë me aktgjykime të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, ndaj drejtuesve politikë, ushtarakë dhe policorë të Jugosllavisë dhe Serbisë. Ajo u zbatua përmes strukturave të një shteti që kishte nën kontroll ushtrinë, policinë dhe mjetet e tjera të pushtetit. Ky është konteksti historik dhe gjyqësor që duhet

të mbetet i qartë sa herë flitet për luftën në Kosovë. 5. Kërkon nga Dhomat e Specializuara të respektojë mandatin në përputhje me vullnetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës. 6. KUNDËRSHTON çdo përpjekje për të përmbysur të vërtetën historike të Kosovës, për të vënë në dyshim luftën e saj çlirimtare apo për të barazuar popullin që luftoi për liri dhe mbijetesë me regjimin që e shtypi atë. 7. E vërteta e luftës çlirimtare, drejtësia për viktimat dhe familjet e tyre dhe e drejta e të dënuarve për një gjykim të drejtë i përkasin së njëjtës Republikë. Kuvendi do t'i mbrojë të tria pa kompromis.

Prishtinë, më 28.09. 2026

Kurti pranoi letra urimi nga kryeministri i Maqedonisë së Veriut dhe i Malit të Zi si dhe nga Ambasada e Gjermanisë

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Në vazhdim të urimeve për formimin e qeverisë dhe mandatin e ri, kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka pranuar letra nga kryeministri i Maqedonisë së

Veriut dhe i Malit të Zi si dhe nga Ambasada e Gjermanisë. Më 13 shtator Kuvendi i Kosovës e ka votuar qeverinë e re të udhëhequr nga Albin Kurti i Lëvizjes Vetëvendosje me 62 vota për, tetë kundër dhe asnjë

abstenim, duke i siguruar Kurtit mandatin e katërt si kryeministër i Kosovës. LV-ja ka 53 deputetë në Kuvend, por qeveria e re u mbështet edhe nga nëntë deputetë të komuniteteve

joshumicë - tetë nga pakicat joserbe dhe nga Nenad Rashiqi i pakicës serbe. Përbërja e kabinetit qeveritar mbetet e njëjtë me atë të qeverisë së tretë të drejtuar nga Kurti.



VIRUSI I NILIT PERËNDIMOR NË KOSOVË: SI PËRHAPET, CILAT JANË SIMPTOMAT DHE SI TË MBROHEMI?

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Nga 7 gushti deri më 18 shtator në Kosovë u regjistruan shtatë raste të infektimit me virusin e Nilit Perëndimor, ndërsa dy persona humbën jetën. Faik Hoti, specialist i shëndetit publik në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), thotë se rastet e regjistruara këtë vit janë kryesisht infeksione të marra brenda Kosovës. Në podkastin 5 pyetje të Radios Evropa e Lirë, Hoti tregon se vetëm një nga personat e infektuar kishte histori udhëtimi jashtë Kosovës, ndërsa të tjerët, sipas anketave epidemiologjike, nuk kishin udhëtuar jashtë shtetit.

Si përhapet virusi i Nilit Perëndimor?

Njerëzit preken nga ky virus kur pickohen nga mushkonjat e infektuara. “Burim i infeksionit janë shpezët e infektuara, ndërsa virusin nga shpezët e infektuara tek njeriu e sjellin mushkonjat”, thotë Hoti. Ai thekson se virusi nuk transmetohet zakonisht nga njeriu te njeriu. “Rastet kur kjo ndodh janë jashtëzakonisht të rralla, dhe janë kryesisht raste kur kemi të



bëjmë me ndonjë lloj transplantimi, ose një lloj transfuzioni të gjakut, në situatat kur personi i infektuar i jep gjak dikujt tjetër, pa e ditur që vetë e ka infeksionin”, thotë Hoti në 5 pyetje. Sipas tij, simptomat e para kanë të bëjnë me kokëdhimbje, me temperaturë, me ethe, me dhimbje në nyje, dhe me dhimbje në muskuj.

Kush është më i rrezikuar?

Virusi mund të prekë njerëzit e të gjitha moshave. Megjithatë, “gjithmonë janë më të atakuar moshat e shtyra, për shkak se personat me moshë të shtyrë janë edhe me sëmundje shoqëruese, apo sëmundje

kronike”, thotë Hoti për REL-in. Hoti tregon se për të dyshuarit për infektim me virusin e Nilit Perëndimor janë të rëndësishme dy elemente: historia e udhëtimit dhe ekspozimi i drejtpërdrejtë ndaj mushkonjave. Ai thotë se dyshimi për infektim rritet nëse një person ka udhëtuar gjatë verës në zona bregdetare me ujëra moçalike, është pickuar nga

mushkonjat dhe më pas ka shfaqur temperaturë apo simptomat e tjera.

Si të mbrohem nga infektimi?

Për parandalimin e infeksionit, rekomandohet shmangia e ekspozimit ndaj mushkonjave, përdorimi i rrjetave në dritare, dhe përdorimi i kremrave kundër pickimit nga mushkonjat kur qëndrohet në natyrë. Aktualisht nuk ka vaksinë për njerëzit kundër virusit të Nilit Perëndimor. “Shkenca, përkundër që është duke bërë hulumtime edhe mund të pritët që ndoshta në të ardhmen edhe të ketë, ende nuk ka arritur që të zhvillojë vaksinën kundër virusit të Nilit Perëndimor”, thotë Hoti. Sipas tij, sezoni i virusit zakonisht fillon në muajin maj, arrin kulmin në gusht dhe shtator, kurse përfundon rreth tetorit. Hoti thotë se vera e gjatë dhe temperaturat e larta mund të kenë ndikuar në shtimin e rasteve këtë vit në Kosovë. Ai shton se ekziston rreziku të paraqiten raste të reja, megjithëse në IKShPK presin që me rënien e temperaturave të ulet edhe përhapja e virusit.

DOGANAT E KOSOVËS, AKTIVE NË BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR DOGANOR

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Doganat e Kosovës morën pjesë në Takimin e Ekipit të Projekteve për Modelin e të Dhënave të Organizatës Botërore të Doganave (OBD), mbajtur në Bruksel, duke kontribuar në zhvillimin dhe zbatimin e mëtejshëm të këtij instrumenti të rëndësishëm për harmonizimin, digjitalizimin, ndërveprueshmërinë dhe

lehtësimin e proceseve ndërkufitare. “Pjesëmarrja në këtë takim dëshmon angazhimin e vazhdueshëm të Doganave të Kosovës për t’u përfshirë në proceset që formësojnë standardet globale doganore, si dhe përkushtimin për ndërtimin e një administrate doganore moderne, të ndërlidhur dhe efikase. Falënderojmë

Sekretariatit të OBD-së, kolegët dhe ekspertët e përfshirë për profesionalizmin, bashkëpunimin dhe punën e vazhdueshme në avancimin e kësaj agjende të rëndësishme. Bashkëpunimi dhe ekspertiza e përbashkët mbeten thelbësore për forcimin e standardeve doganore në nivel global”, ka njoftuar Dogana e Kosovës.



KRU “Prishtina” investon mbi një milion euro për modernizimin e autoparkut



PRISHTINË, 28 SHTATOR - Kompania Rajonale e Ujësjellësit (KRU) “Prishtina” ka zgjeruar dhe modernizuar flotën e autoparkut, në kuadër të investimeve për rritjen e kapaciteteve operative dhe përmirësimin e shërbimeve për konsumatorët. Sipas kompanisë, në kuadër të këtij investimi janë siguruar gjithsej

20 mjete të reja, të përbëra nga: 10 vetura, 7 kamioneta, 2 ekskavatorë, 1 autobot. Vlera e përgjithshme e investimit është mbi një milion euro. Nga KRU “Prishtina” kanë thënë se mjetet e reja do të mundësojnë rritjen e efikasitetit të ekipeve në terren, reagim më të shpejtë ndaj

intervenimeve dhe kërkesave të konsumatorëve si dhe forcimin e kapaciteteve operative të kompanisë. Sipas kompanisë, ky investim përbën një hap të rëndësishëm në modernizimin e flotës dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve që ofrohen për konsumatorët.

NËNTË TË ARRESTUAR PËR KRIME LUFTE NË ZUBIN POTOK LIDHUR ME RASTIN E “GRUPIT TË INTELEKTUALËVE”

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Gjatë një operacioni të zhvilluar në Zubin Potok, nëntë persona janë arrestuar nën dyshime për krime lufte kundër popullatës civile, thanë autoritetet mëngjesin e së dielës.

Operacioni ndërlidhet me rastin e njohur si “Grupi i Intelktualëve”.

Operacioni nxiti reagime të ashpra nga Lista Serbe dhe Serbia.

Prokuroria Speciale e Kosovës më vonë gjatë së dielës tha se të nëntë personat, me vendim të saj, janë ndaluar për 48 orë.

Ajo identifikoi të arrestuarit vetëm me iniciale: D. D., M. R., M. R., R. R., S. D., S. D., V. L., R. R. dhe D. D., teksa listoi edhe se çfarë u sekuestrua si prova materiale gjatë kontrolleve në disa lokacione në komunën e Zubin Potokut.

Si prova, tha Prokuroria, u sekuestruan telefona mobilë, dy librezat ushtarake, një armë e gjatë dhe një pushkë gjuetie, fishekë, katër predha, para të gatshme në vlerë prej 23 mijë eurosh dhe para të gatshme në vlerë prej rreth 60 mijë dinarësh serbë (rreth 500 euro).

Operacioni, i koduar “Dosja 23” u realizua në orët e hershme të mëngjesit të 27 shtatorit në Zubin Potok, në veriun e Kosovës, të banuar me shumicë serbe.

Ai u krye nga Policia e Kosovës, me urdhër të Prokurorisë Speciale, dhe vjen pasi më 19 shtator u konfirmua, përmes analizës së ADN-së, se mbetjet mortore të tri viktimave të gjetura në varrezat masive në Zubin Potok, i përkisnin “Grupit të Intelktualëve”. Më vonë, familjarët konfirmuan se një nga viktimat e identifikuar ishte Idriz Rrecaj.

Lista Serbe dhe Serbia reagojnë ashpër për arrestimet

Lidhur me arrestimet në komunën e Zubin Potokut ka reaguar Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë, që gëzon mbështetjen e Beogradit. Në reagimin e kësaj partie lidhur me arrestimet u tha se në veri të Kosovë ka “frikë, shqetësim dhe pasiguri”.

“Ky nuk është një proces ligjor, me respekt të plotë për prezumimin e pafajësisë dhe të drejtën për mbrojtje, por hakmarrje dhe mënyra e



[kryeministrit të Kosovës, Albin] Kurtit për përndjekjen e serbëve. Fakt është se serbët në Zubin Potok muajt e fundit janë nën një terror të tmerrshëm që të kujton një pushtim”, thuhet në reagimin e Listës Serbe.

Aty thuhet se publikut nuk i janë paraqitur fakte konkrete që do ta “justifikonin këtë trajtim ndaj familjeve të tëra dhe komuniteteve lokale”.

Nga Lista Serbe kërkuan që të arrestuarve t’u sigurohet kontakt i papenguar me avokatët dhe familjet, si dhe që procesi të mos jetë i ndikuar nga presioni politik.

Reagime pati edhe në Serbi. Presidenti serb, Aleksandar Vuçiq, e cilësoi arrestimin e serbëve në Zubin Potok si

“metodën më perfide të spastrimit etnik”. “Po dëgjoj se Kurti dhe njësitë e tij speciale kanë arrestuar sërish serbë, nëntë prej tyre, në komunën e Zubin Potokut, për krime të dyshuara lufte. Dhe e gjithë kjo do të heshtet nga bota, dhe do të bëhen sikur nuk dinë, sikur nuk e dinë se bëhet fjalë për metodën më perfide dhe më të paskrupullt të spastrimit etnik”, tha Vuçiqi për transmetuesin publik serb. Ai shtoi se Serbia ka angazhuar avokatë dhe se është në kontakt me familjet e serbëve të arrestuar.

Ndërkaq, Zyra për Kosovën në Qeverinë serbe po ashtu pretendoi se operacione të tilla policore synojnë “dëbimin” dhe “frikësimin” e serbëve në

Kosovë, duke shtuar se nëntë të arrestuarit janë serbë dhe operacioni u krye në pesë fshatra të Zubin Potokut. Sipas këtij institucioni të qeverisë serbe, policia e kreu operacionin në orën 06:00 në fshatrat Dren, Kalludër, Bregu i Madh, Crepulë dhe Uglarë. Kjo zyrrë pretendoi se në mesin e të arrestuarve është edhe një 90-vjeçar. “Të arrestuar janë edhe të afërm të serbëve që tashmë kanë qenë cak i Prishtinës”, pretendoi Zyra e Qeverisë serbe, e cila shtoi se të arrestuarit kanë jetuar në Zubin Potok për më shumë se dy dekada. “Arrestimet masive janë bërë metoda e re e Prishtinës për hakmarrje ndaj serbëve, ndërsa zbulimet e fundit në Zubin

Potok, Prishtina i përdor si pretekst për stigmatizimin dhe gjuetinë e të gjithë serbëve të mbetur”, u tha në njoftimin e Zyrës, ku u shtua se me arrestimet e reja “Kurti dëshiron të zhvillojë edhe një fushatë politike përmes së cilës synon ta largojë vëmendjen e opinionit publik në Prishtinë nga aktakuzat e Hagës ndaj drejtuesve të UÇK-së”.

Ndryshe, “Grupi i Intelktualëve” përbëhej kryesisht nga qytetarë nga Skenderaj dhe Mitrovica, të cilët, sipas autoriteteve në Kosovë, ishin rrëmbyer dhe zhdukur me dhunë më 19 prill 1999 nga forcat serbe.

Në mesin e 23 personave të këtij grupi shqiptarësh kishte veprimtarë, profesionistë dhe figura publike nga zona e Mitrovicës, të cilët u zhdukën në zonën e Zubin Potokut.

Në gusht të këtij viti, autoritetet kryen gërmime në Kalludër dhe Jabukë të Zubin Potokut ku zbuluan tri varreza masive dhe u gjetën mbetjet mortore të të paktën 23 persona. Më pas, mostrat e mbetjeve mortore u dërguan në Hagë të Holandës për identifikim përmes ADN-së. Sipas kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, pritet që në “javët në vijim” Kosova t’i pranojë rezultatet edhe për mostrat e tjera që u dërguan në Hagë për ekzaminim.

Varrezat në Zubin Potok u zbuluan pas një hetimi dyvjeçar lidhur me dyshimet për krime lufte, sipas Prokurorisë Speciale. Paraprakisht për këtë rast janë arrestuar katër persona, të identifikuar me iniciale J. R., M. J., R. K. dhe M. B., të cilët janë të dyshuar për krime lufte kundër popullsisë civile.

Që të katër ndodhen në paraburgim.

Një nga të arrestuarit, sipas autoriteteve, dyshohet se në kohën e luftës kishte qenë pjesë aktive e Armatës Jugosllave. Sipas Institutit të Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, 1 577 persona vazhdojnë të jenë të zhdukur nga lufta e viteve 1998-1999, ndërsa janë dokumentuar gjithsej 12 230 viktima të luftës.

Kosova ka kërkuar vazhdimisht nga Serbia bashkëpunim për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur dhe qasje në arkivat ushtarake që, sipas autoriteteve, mund të ndihmojnë në identifikimin e lokacioneve të varreve të mundshme.

Prishtina në Bloomberg Global HQ në tavolinën e ideve që po ndryshojnë botën

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Në selinë globale të Bloomberg në Nju-Jorku, kryetari i kryeqytetit, Përparim Rama, diskutoi për ndryshimet gjeoekonomike dhe

ndikimin që inteligjenca artificiale dhe të dhënat e mëdha po kanë në ekonominë globale.

Ai ka theksuar se Prishtina është një nga kryeqytetet më

të reja të Evropës, me të rinj të talentuar, kreativë dhe të lidhur natyrshëm me teknologjinë. Kjo gjeneratë është një prej potencialeve më të mëdha të qytetit.

Gjatë kësaj vizite kryetari Rama paraqiti ambicien për ta lidhur Prishtinën edhe më fuqishëm me ekonominë, teknologjinë dhe mundësitë globale.



ASK-ja publikon të dhënat për emetimet në ajër: Sektori energjetik shkakton 82.8% të CO²

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e hulumtimit statistikor “Llogaritë e Emetimeve në Ajër (LLEA) 2023”, që paraqet të dhëna për emetimet në ajër nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë në Kosovë. Ky është publikimi i katërt i këtij lloji i realizuar nga ASK-ja.

Qëllimi i hulumtimit është ofrimi i të dhënave të qëndrueshme statistikore për emetimet në ajër dhe ndërtimi i një sistemi statistikor për Llogaritë e Emetimeve në Ajër. Sipas rezultateve të ASK-së, Sektori D - furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar - ishte përgjegjës për rreth 82.8 për qind të



emetimeve të CO₂ në vitin 2023. Pas tij renditet Sektori C - Prodhimi, me rreth 15.5 për

qind të emetimeve të CO₂. Ndërkaq, Sektori A - Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi, përbënte rreth 1.1 për qind të emetimeve, ndërsa Sektori F - Ndërtimi, rreth 0.02 për qind. ASK-ja thekson se rezultatet e këtij publikimi paraqesin një burim të rëndësishëm statistikor për vlerësimin e gjendjes së emetimeve në ajër

nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë në Kosovë. Metodologjia e përdorur për realizimin e publikimit është në përputhje me Rregulloren e Bashkimit Evropian (BE) nr. 691/2011, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 6 korrik 2011, për Llogaritë Ekonomike Mjedisore Evropiane.

LUGINA SHPËTOHET ME EKONOMI, INVESTIME DHE PUNË - AKB DHE BIZNESET SHQIPTARE BASHKOJNË FORCAT NË BUJANOC

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Në kuadër të Edicionit të 4-t të Konferencës “Ekonomia shpëton Luginën e Preshevës”, të organizuar nga Unioni i Afaristëve për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, vizitoi komunën e Bujanocit së bashku me një delegacion të gjerë të komunitetit të biznesit. Në delegacion morën pjesë përfaqësues të AKB-së, Unioni i Afaristëve për PBM, Rrjetit Global të Bizneseve, bizneseve nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut dhe shumë nga EU me një mesazh të qartë: zhvillimi ekonomik, investimet dhe bashkëpunimi i biznesit janë ndër shtyllat kryesore për një të ardhme më të mirë të Luginës së Preshevës. Gjatë vizitës në komunën e Bujanocit u diskutua për

mundësitë konkrete të investimeve, bashkëpunimit ndërmjet bizneseve, hapjes së vendeve të punës, zhvillimit të ndërmarrjeve dhe lidhjes së Luginës së Preshevës me tregjet e Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe më gjerë. Kryetari i komunës së Bujanocit, Arbër Pajaziti, u bëri thirrje bizneseve shqiptare nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe diaspora që ta shohin Bujanocin si një hapësirë të përbashkët për investime dhe zhvillim. “Bujanoci është shtëpia juaj. Secili prej jush që vjen këtu për të investuar, për të hapur një biznes apo për të krijuar vende pune, duhet ta ndiejë veten në shtëpinë e vet. Ne i mirëpresim investimet dhe partneritetin tuaj, sepse vetëm përmes zhvillimit ekonomik dhe vendeve të reja të punës mund



ta ndalim migrimin e madh dhe t'u krijojmë të rinjve perspektivë për të jetuar dhe punuar këtu”, u shpreh Arbër Pajaziti. Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, theksoi se Lugina e Preshevës nuk ka nevojë vetëm për deklarata, por për investime,

kapital, vende të reja pune dhe partneritete konkrete ekonomike. “Ekonomia është ura që lidh njerëzit, bizneset dhe tregjet. Lugina e Preshevës duhet të jetë pjesë aktive e zhvillimit ekonomik rajonal. Kur biznesi bashkohet, krijohen

mundësi, vende pune dhe perspektivë për të rinjtë”, tha ai. AKB-ja vlerëson se Kosova, Shqipëria, Lugina e Preshevës dhe Maqedonia e Veriut kanë potencial të madh për të krijuar një hapësirë më të fuqishme ekonomike përmes investimeve të përbashkëta, tregtisë, prodhimit dhe projekteve ndërkufitare. Konferenca “Ekonomia shpëton Luginën e Preshevës” përcjell një mesazh të fuqishëm se zhvillimi ekonomik duhet të jetë prioritet dhe se biznesi mund të jetë një nga faktorët kryesorë të perspektivës së Luginës. Shahini ka theksuar se AKB-ja do të vazhdojë të jetë pjesë e nismave që bashkojnë bizneset shqiptare dhe rajonale, duke promovuar investimet, bashkëpunimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

BIZNESET E KOSOVËS DHE TURQISË TAKOHEN NË PRISHTINË PËR BASHKËPUNIME TË REJA

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Më 29 shtator në “Hotel Emerald” në Prishtinë do të mbahet takimi Kosovë - Turqi B2B Business Meeting, i cili do të bëjë bashkë përfaqësues të kompanive nga të dyja vendet. Ngjarja organizohet nga Türkiye Exporters Assembly (TİM) në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë dhe Odën Ekonomike të Kosovës me synim krijimin e kontakteve të reja mes bizneseve, zhvillimin e partneriteteve dhe identifikimin e mundësive konkrete për bashkëpunim



tregtar. Takimi B2B është pjesë e vizitës së delegacionit tregtar turk në Kosovë, që zhvillohet në Prishtinë nga 28 deri më 30 shtator 2026. Në kuadër të takimeve do të marrin pjesë kompani turke nga sektorë të ndryshëm, përfshirë industrinë ushqimore, tekstilin, kozmetikën, pajisjet mjekësore, materialet e ndërtimit, mobilitet, industrinë automobilistike, makineritë bujqësore, inxhinierinë dhe produktet kimike. Përmes takimeve të drejtpërdrejta, kompanitë nga

Kosova do të kenë mundësi të njihen me ofertat dhe aktivitetin e bizneseve pjesëmarrëse nga Turqia, të shkëmbejnë kontakte dhe të diskutojnë për mundësi të reja partneriteti. Türkiye Exporters Assembly (TİM) është organizata ombrellë e shoqatave të eksportuesve në Turqi dhe përfaqëson mbi 150 mijë kompani eksportuese. Takimi do të nisë në orën 10:00, ndërsa kompanitë e interesuara për pjesëmarrje mund të regjistrohen paraprakisht përmes formularit të organizatorëve.

Ministrja Kusari-Lila: MINTI po punon për përmbushjen e objektivave të Planit të Rritjes

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, ka marrë pjesë në mbledhjen e dytë të Këshillit Ministror për Integrim Evropian - Komitetit Drejtues për Instrumentin e Planit të Rritjes. Ministrja Kusari-Lila ka bërë me

dije se në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit po punohet intensivisht për përgatitjen e projektligjeve dhe akteve nënligjore, që lidhen me objektivat e Kosovës në kuadër të Planit të Rritjes. Ajo ka theksuar se një nga sfidat kryesore në këtë proces, i cili ka

rëndësi të lartë për vendin, mbetet funksionaliteti i plotë i institucioneve dhe mbarëvajtja e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës. Sipas ministres Kusari-Lila, Kosova ka nevojë për stabilitet institucional dhe një rrugë të qëndrueshme drejt integritetit evropian dhe zhvillimit ekonomik.



ÇFARË DIMË PËR HETIMIN KUNDËR TERRORIZMIT NË BAZËN AMERIKANE NË BRITANI



Pesë burra janë arrestuar nën dyshimin për vepra penale me eksplozivë dhe terrorizëm, pasi një incident i madh u deklarua në një bazë ajrore në perëndim të Anglisë. Ekipet e çaktivizimit të bombave kanë shqyrtuar një numër automjesh pranë RAF Fairford në Gloucestershire dhe dhjetëra shtëpi në zonën përreth janë evakuuar. Ja një përmbledhje e asaj që dimë deri më tani.

Ku është Forca Ajrore RAF Fairford?

RAF Fairford ndodhet në Cotswolds, rreth katër milje (6.4 km) në jug të qytetit të Fairford, i cili shtrihet përgjatë lumit Coln. Baza ndan një histori të gjatë me ushtrinë amerikane dhe kohët e fundit është përdorur nga avionët luftarakë amerikanë si një pikë referimi për sulme mbrojtëse ndaj Iranit. Policia e Gloucestershire tha se mori një telefonatë në lidhje me “tre automjete të dyshimta” që udhëtonin drejt RAF Fairford në orën 00:45 BST të dielën. Pesë burra u arrestuan më vonë nga oficerët e saj pranë Whelford, një fshat rreth dy milje (3.2 km) në juglindje të bazës. Një ekip për çaktivizimin e bombave u dërgua gjithashtu në fshat për të shqyrtuar një numër automjesh, tha policia, rreth të cilave është vendosur një kordon prej 400 metrash. Pamjet ajrore treguan një robot të kontrolluar nga distanca që po i afrohej dy furgonëve të bardhë të palëvizshëm në një zonë të pyllëzuar, megjithëse përdorimi i tij nuk është konfirmuar nga policia. Policia Kundër Terrorizmit (CTP) po udhëheq hetimin për

incidentin. BBC kupton se operacioni nuk ishte i udhëhequr nga intelijenca. Ushtria amerikane tha se po “punonte ngushtë” me homologët e saj britanikë “për të monitoruar këtë situatë, për të minimizuar ndikimet dhe për të siguruar sigurinë e personelit amerikan, familjeve të tyre dhe komunitetit lokal”. Që nga orët e para të së dielës ka pasur një prani të madhe të shërbimeve emergjente në zonë, të cilën Shefi i Përkohshëm i Policisë së Gloucestershire, Maggie Blyth, tha se do të mbetet gjatë ditëve të ardhshme. Blyth tha në një konferencë për shtyp të dielën në mbrëmje se forca do të vazhdojë të ndihmojë CTP-në dhe të bashkëpunojë me partnerë të tjerë kombëtarë. Pesë burra u ndaluan fillimisht me dyshimin për kryerjen e veprave penale sipas Aktit të Eksplozivëve. Ata u arrestuan më pas nën dyshimin për përgatitje të një akti terrorist. Burrat, të cilët mbeten në paraburgim, nuk janë emëruar. Policia nuk ka thënë se ku po mbahen ata. Të dyshuarit e arrestuar sipas Aktit të Terrorizmit të vitit 2000 mund të mbahen në paraburgim deri në 14 ditë pa akuzë, krahasuar me limitin 24-orësh për arrestimet standarde pa kërkesë për zgjatje të afatit. E pyetur nëse policia po kërkonte individë të tjerë në lidhje me incidentin, Blyth tha se besonte që çështja ishte “e kontrolluar”. Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, tha se të arrestuarit “po kërkonin të shkaktonin dëme të mëdha”, duke shtuar: “I kishim nën vëzhgim për një kohë të gjatë dhe i kapëm”. Ky imazh ka qarkulluar pas arrestimeve të pesë burrave pranë

RAF Fairford. BBC Your Voice ka marrë një imazh që pretendon të tregojë momentin kur u arrestuan pesë burra. Në të tregoheshin burra të ndaluar në Whelford, rreth 350 metra nga qasja në pistën e Crash Gate 6A në RAF Fairford. BBC nuk ka qenë në gjendje të verifikojë burimin origjinal, por BBC Verify e ka gjeolokuar imazhin dhe ka konfirmuar se duket të jetë autentik.

‘Thirrja ime në 999 prishi çdo plan që kishin’

Një banore që telefonoi 999 për të raportuar tre furgonët e bardhë në fshatin Whelford tha se ishte “fat i pastër” që i vuri re automjetet. Duke folur për programin Today të BBC Radio 4, gruaja, e cila dëshiron të mbetet anonime, tha se kur mbërriti në shtëpi gjeti hyrjen dhe rrugën të bllokuara dhe pa një “grup të madh burrash me kapuç dhe maska”. “Kur më panë, vrapuan përpara meje – disa në fushë dhe disa drejt fshatit fqinj Kempford. Pastaj kuptova se po ndodhte diçka shumë e pazakontë”, shtoi ajo. Gruaja i tha programit se telefonoi policinë e Ministrisë së Mbrojtjes në RAF Fairford, por nuk mori përgjigje. Më pas ajo telefonoi në numrin 999 në orën 01:36 BST dhe tha se “brenda 10 minutash fshati ishte plot me policë të armatosur”.

“Unë besoj se thirrja ime në 999 prishi çdo plan që kishin.”

“Jam absolutisht e habitur që më është lënë mua si anëtare e publikut ta shoh dhe ta raportoj këtë,” tha ajo.

“Dikush me të vërtetë e ka humbur topin në këtë”

Një banor tjetër përshkroi momentin kur tha se pa policinë të arrestonte të dyshuarit. Jeff – i cili nuk e dha mbiemrin e tij – i tha BBC-së se dëgjoi “britma jashtë derës së tij të përparme”, megjithëse nuk ishte i sigurt se nga vinin. Ai tha se më pas shikoi nga dritarja dhe pa “njerëz që mbaheshin nga policia jashtë”. Policia e Gloucestershire tha se banorëve të zhvendosur u është thënë se nuk do të jenë në gjendje të kthehen në shtëpitë e tyre të dielën në mbrëmje. Akomodimi për një natë do të gjendet nga Këshilli i Qarkut Cotswold për ata të prekur që nuk janë në gjendje të qëndrojnë me familjen dhe miqtë, sipas Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv David Stanley. Tetëdhjetë e pesë familje u evakuuan pas incidentit dhe u nxitën të strehoheshin në një qendër argëtimi aty pranë. Disa njerëz i kanë thënë BBC-së se janë zgjuar nga policia në orët e para të së dielës dhe u është urdhëruar të largohen. “Na u desh të vishnim rrobat dhe të vinim. Nuk dinim asgjë”, tha një banore, e cila e quajti veten vetëm Jo. Një banor tjetër, Jason, tha: “Gjithçka ndodhi shumë shpejt. Ne thjesht mblodhëm gjërat tona dhe erdhëm këtu.” Disa njerëz në qendrën e kohës së lirë ende veshin pizhame, sipas një gazetari të BBC-së atje.

Çfarë ka thënë qeveria e Mbretërisë së Bashkuar?

Kryeministri Andy Burnham tha se incidenti ishte “thellësisht

shqetësues” dhe se qeveria “do të ndërmarrë gjithmonë çdo hap të nevojshëm” për të mbrojtur njerëzit. Sekretari i tij i mbrojtjes, Wes Streeting, nuk pranoi të komentonte mbi një operacion të drejtpërdrejtë, por tha se kishte qenë në kontakt me homologun e tij amerikan, Pete Hegseth. I pyetur në një aktivitet periferik në konferencën e Partisë Laburiste në Liverpool nëse kishte ndonjë përfshirje iraniane, ai tha se ishte “shumë herët për të komentuar ose speculuar, dhe do të ishte e papërgjegjshme nga ana ime ta bëja këtë”.

Për çfarë përdoret RAF Fairford?

Baza ajrore RAF Fairford është përdorur si një vendndodhje operative e avancuar nga Forcat Ajrore të SHBA-së (USAF) për dekada të tëra. Baza u pushtua nga Komanda Strategjike Ajrore e USAF gjatë Luftës së Ftohtë dhe më vonë gjatë Luftës së Parë të Gjirit në vitin 1991. Bombarduesit B-52 u vendosën gjithashtu nga USAF nga RAF Fairford në bastisje në Irak në vitin 2003. U përdor më së fundmi më 1 mars, pas një vendimi të ish-kryeministrit të Mbretërisë së Bashkuar, Sir Keir Starmer, për të lejuar SHBA-në të përdorë bazat e Mbretërisë së Bashkuar – përfshirë RAF Fairford – për sulme “mbrojtëse” ndaj kapaciteteve iraniane. Konflikti shpërtheu në të gjithë Lindjen e Mesme pasi SHBA-të dhe Izraeli nisën sulme të gjera ndaj Iranit më 28 shkurt. Irani u përgjigj duke nisur sulme ndaj Izraelit dhe shteteve aleate të SHBA-së në Gjirin Persik./BBC

SHBA TËRHIQET NGA IRAKU, FORCAT AMERIKANE LARGOHEN PLOTËSISHT NGA VENDI

Forcat e armatosura amerikane janë tërhequr plotësisht nga territori irakian, sipas një burimi qeveritar në Bagdad, i cili e bëri të ditur informacionin për agjencinë gjermane të lajmeve DPA. Sipas burimit, nga Iraku janë larguar si forcat luftarake, ashtu edhe njësitë mbështetëse amerikane. Megjithatë, deri tani nuk ka pasur një konfirmim zyrtar nga Uashingtoni për përfundimin e tërheqjes. Qeveritë e të dy vendeve kishin arritur një marrëveshje për tërheqjen e forcave amerikane. Sipas Pentagonit, rreth 2,500 trupa amerikane ishin të stacionuara në Irak gjatë viteve të fundit. Para tërheqjes, forcat amerikane

ishin të vendosura në disa pika strategjike, përfshirë baza në Erbil, në rajonin autonom të Kurdistanit, aeroportin e Bagdadit, si dhe në Zonën e Gjellbër, ku ndodhen institucionet qeveritare dhe ambasadat e huaja. Një koalicion ushtarak i udhëhequr nga SHBA-ja u përfshi në fushatën kundër organizatës terroriste ISIS në Irak dhe Siri në vitin 2014. Organizata humbi kontrollin mbi territorin e saj në Irak në vitin 2017 dhe në Siri në vitin 2019. Megjithatë, qelizat e ISIS-it mbeten aktive dhe vazhdojnë të kryejnë sulme sporadike në të dyja vendet. Situata e sigurisë në Irak është përkeqësuar sërish pas



përshkallëzimit të konfliktit në Lindjen e Mesme. Forcat amerikane dhe grupet e armatosura të lidhura me Iranin janë përfshirë në përplasje të përsëritura gjatë viteve të fundit. Që nga shpërthimi i konfliktit të fundit, janë raportuar qindra sulme, veçanërisht ndaj forcave dhe instalimeve amerikane. Irani dhe grupet e armatosura aleate me të në Irak pritet ta mirëpresin tërheqjen e trupave amerikane. Duke nisur nga e mërkura, dita kur ushtria amerikane pritet të largohet, Iraku planifikon një festë katërditore për të shënuar atë që është cilësuar si “Dita e Pavarësisë”.

“DIPLOMACIA E PANDAVE” RIKTHEHET NË SHBA!

Dy panda gjigante nga Kina kanë mbërritur në Kopshtin Zoologjik të Atlantës, ku do të qëndrojnë për 10 vjet në kuadër të një marrëveshjeje për ruajtjen dhe shumimin e species. 6-vjeçari Ping Ping dhe 5-vjeçarja Fu Shuang udhëtuan rreth 8 mijë milje nga Kina drejt SHBA-së. Ata u transportuan me një avion, të shoqëruar me bambu të freskët, ujë dhe ushqimet e tyre të preferuara. Përpara udhëtimit, pandat iu nënshtruan një periudhe karantine dhe u trajnuan për të qëndruar në arkat e transportit

dhe për t'u përshtatur me zhurmat e udhëtimit. Megjithatë, vizitorët nuk do të mund t'i shohin menjëherë. Ping Ping dhe Fu Shuang do të qëndrojnë rreth një muaj në karantinë, përpara se të prezantohen me publikun. Ardha e tyre në Atlanta ka edhe një rëndësi për programet e ruajtjes së pandave. Kafshët konsiderohen ende të cenueshme dhe riprodhimi në robëri është veçanërisht i vështirë, pasi femrat janë pjellore vetëm për një periudhë shumë të shkurtër çdo vit.

Ping Ping dhe Fu Shuang janë përzgjedhur për moshën, shëndetin, karakteristikat gjenetike dhe personalitetin e tyre, me shpresën se do të çiftëzohen natyrshëm. Dy pandat janë gjithashtu pjesë e asaj që njihet si “diplomacia e pandave”, përmes së cilës Kina ka përdorur prej dekadash huazimin e pandave si një formë të marrëdhënieve diplomatike me vende të tjera. Sipas marrëveshjes, pandat dhe pasardhësit e tyre do të mbeten pronë e Kinës dhe do të kthehen atje në të ardhmen.



PARALAJMËRIMI I INTELIGJENCËS DANEZE: RUSIA DO TË SULMOJË NATO-N



Rusia mund të ndërmarrë sulme të kufizuara ndaj vendeve të NATO-s, ndërsa tensionet me Evropën rriten. Paralajmërimi vjen nga shërbimi danez i inteligjencës ushtarake, në raportin e publikuar më 24 shtator. Sipas Corriere della Sera, një pushtim i plotë i një vendi të NATO-s mbetet shumë i pamundur, por rreziku për incidente ushtarake të kufizuara është në rritje. Inteligjenca daneze vlerëson se Moska mund të tentojë të testojë reagimin e Aleancës përmes sulmeve ndaj infrastrukturës,

sabotazheve ose operacioneve të tjera që mund të shkaktojnë përçarje brenda NATO-s. Në raport thuhet gjithashtu se lufta hibride ruse ndaj vendeve evropiane po përshkallëzohet. Në fokus janë sulmet kibernetike, sabotazhet dhe ndërhyrjet që synojnë të pengojnë mbështetjen ushtarake të Evropës për Ukrainën. Një tjetër shqetësim i ngritur nga danezët është mundësia e përdorimit të operacioneve me flumur të remë, përfshirë sulme me dronë që mund të paraqiten si veprime të Ukrainës.

Sipas inteligjencës daneze, Kremli e sheh forcimin ushtarak të Evropës si një kërcënim në rritje dhe mund të konsiderojë vitet e ardhshme si një periudhë vendimtare. Megjithatë, raporti thekson se një sulm ndaj një vendi të NATO-s do të ishte i rrezikshëm për Rusinë, pasi do të mund të shkaktonte një përgjigje të përbashkët ushtarake të Aleancës. Skenari më i rrezikshëm, sipas analizës, do të ishte një llogaritje e gabuar nga Moska lidhur me gatishmërinë e NATO-s për të reaguar së bashku.

Ministri izraelit, komandantit të Hamasit: Do të të ekzekutoj

Ministri i Sigurisë Kombëtare të Izraelit, Itamar Ben-Gvir, i tha një komandanti të lartë të Hamasit, të burgosur në Izrael, se do të kërkonte ekzekutimin e tij nëse do të bëhej ministër i Mbrojtjes. Ben-Gvir i tha Hassan Salama-s, një komandanti të lartë të krahut të armatosur të Hamasit, Brigadave Izz el-Deen al-Qassam, se dëshironte që ai të vritej dhe se do të urdhëronte ekzekutimin e tij. “Kur isha djalë, protestoja


kundër sulmeve me bomba që kryet në linjën 18 të autobusëve në Jerusalem, ku u vranë 48 njerëz. Ju vratë fëmijë, gra, burra dhe ushtarë gjithashtu, emrat e të cilëve ua kam vendosur fëmijëve të mi. Kur isha djalë, dola të protestoja, duke kërkuar që të merreshin masa ndaj njerëzve si ju. Sot e mbyll këtë cikël. Kur u rrita, këto janë kushtet në të cilat të kam vendosur, por ky nuk është fundi. Dua të të vras, do të të ekzekutoj. Një person që ka vranë

48 ushtarë, gra, fëmijë dhe të moshuar duhet të vritet, duhet të vritet. Dhe kjo është përveç ferrit me të cilin do të përballesh. Po të them, ferr. Ndërsa ti mendon për virgjëreshat, do të shkosh në ferr, në ferr. Dhe unë do të jem ferri këtu. Atje lart do të jetë Zoti, Allahu, ndërsa unë do të jem përgjegjës për ferrin këtu. Dhe është mirë që do të kesh ferr këtu”, i thotë Ben-Gvir. Pamjet e takimit u publikuan të dielën, më 27 shtator, por autoritetet nuk kanë dhënë

datwn e saktw se kur ka ndodhur kjo takim. Gjatë tij, Ben-Gvir mbante në jakë një distinktiv që paraqiste një lak litari. Salama është akuzuar nga Izraeli se ka organizuar një seri sulmesh vetëvrasëse me bomba në vitin 1996, të kryera pas vrasjes nga Izraeli të Yahya Ayyash, ekspertit të Hamasit për prodhimin e bombave. Sulmet shkaktuan vdekjen e dhjetëra izraelitëve dhe plagosjen e qindra të tjerëve.



Salama, me origjinë nga Gaza, u dënua nga gjykatat izraelite me 48 dënime të përjetshme, plus 30 vite burg, duke marrë një nga dënimet më të gjata të dhëna ndaj një të burgosuri palestinez. Izraeli ka vënë veton ndaj liritimit të Salama-s në marrëveshjet e mëparshme për shkëmbimin e të burgosurve me Hamasin.



“Me Kosovën i dërgon mesazh Spallettit”, gazeta italiane shkruan për formën e Edon Zhegrovës

TORINO, 28 SHTATOR - Gazeta e njohur italiane “Calciomercato” ka shkruar për sulmuesin e Kosovës, Edon Zhegrova, i cili ka shënuar në humbjen 3-1 ndaj Austrisë. Ylli i Juventusit ka hyrë si zëvendësues në pjesën e dytë, ndërsa ka realizuar golin e vetëm për “Dardanët”, duke shënuar nga pika e bardhë. Forma e mirë e Zhegrovës së fundmi ka tërhequr vëmend-

jen e medieve në Itali, me mediumin e lartpërmendur që ka shkruar se ai i ka dërguar një mesazh të qartë trajnerit Luciano Spalletti. “Penalltia nuk e largoi humbjen nga Austria, por e konfirmoi formën e fortë të Edon Zhegrovës. Me këtë gol ai ka arritur në tre gola dhe një asistim në gjashtë ndeshjet e para të këtij sezoni. Ky është gjithashtu një mesazh i rëndësishëm për Luciano

Spallettin, i cili asnjëherë nuk arriti të mbështetej në versionin e tij më të mirë sezonin e kaluar”, ka shkruar mediumi italian. “Calciomercato”, ndër të tjera, ka shtuar se tani Zhegrova do të garojë me Francisco Conceicao për një vend në formacionin titullar. “Ai tashmë mund të ketë një rol më të rëndësishëm në rotacionin e Juventusit, duke pasur vetëm

dy kompeticione për të garuar me bashkëlojtarët (Seria A dhe Kupën e Italisë). Me formacionin 4-2-3-1 që përdor Luciano Spalletti, kosovari është kandidat për pozitën e Conceicao në krahun e djathtë”, ka shkruar “Calciomercato”. Ndërkohë, Zhegrova është i fokusuar te Kosova, ku të enjten do të përballlet me Izraelin në Hungari.



KOSOVA NDALET NË VJENË NGA AUSTRIA, TANI FOKUSI TE SFIDA E RADHËS NDAJ IZRAELIT

VJENË, 28 SHTATOR - Kombëtarja e Kosovës ka pësuar humbje 3:1 në përballje me favoriten e grupit, Austrinë, në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin “Ernst Happel” në Vjenë, në kuadër të xhiros së dytë të Grupit B3 të Ligës së Kombeve. “Dardanët” edhe në këtë ndeshje kanë pasur mbështetje të jashtëzakonshme nga tribunat, ku një numër i madh i tifozëve shqiptarë krijuan atmosferë të veçantë gjatë gjithë ndeshjes. Kosova e ka nisur mirë takimin dhe kishte rastin e parë të artë në minutën e 6, kur Vedat Muriqi ka dalë i vetëm përballë portierit austriak, por goditja e tij ka përfunduar mbi portë. Austria ka kaluar në epërsi në minutën e 23-të. David Affengruber ka shënuar me kokë pas një dueli në zonë, ndërsa goli është konfirmuar pas rishikimit nga VAR-i. Kosova ka kërkuar reagimin dhe

golin e barazimit, por krejt në fund të kohës shtesë të pjesës së parë Austria ka shfrytëzuar një kundërsulm të shpejtë, kur Junior Adamu ka realizuar për 2:0. Për pjesën e dytë, përzgjedhësi Franco Foda ka bërë tri zëvendësime, duke inkuadruar Edon Zhegrovën, Milot Avdylin dhe Valmir Matoshin. Megjithatë, Austria ka shënuar edhe golin e tretë në minutën e 61-të. Carney Chukwuemeka ka përfutur nga një aksion në zonën e Kosovës dhe ka realizuar për 3:0. Në këtë aksion është lënduar edhe portieri Aro Muriqi, i cili është zëvendësuar nga Amir Saip, derisa më pas është inkuadruar në lojë edhe Fisnik Asllani. Kosova nuk është dorëzuar, duke vazhduar ta kërkonte golin dhe në minutën e 83-të ka fituar penallti pas një ndërhyrjeje ndaj Valmir Matoshit. Nga pika e bardhë i saktë ishte Edon Zhegrova, i cili ka



ngushtuar rezultatin në 3:1. Në minutat e mbetura, Kosova ka pasur iniciativën dhe ka tentuar të rikthehej në lojë, por Austria ka arritur ta menaxhojë epërsinë dhe ta mbyllë ndeshjen me fitore. Austria ka regjistruar 11 goditje

gjithsej, pesë prej të cilave në kuadër të portës, ndërsa Kosova ka pasur gjashtë goditje, me katër në kuadër të portës. Kjo ishte ndeshja e dytë e Kosovës në Grupin B3, pas fitores 1:0 ndaj Irlandës në “Fadil Vokrri”.

“Dardanët” tani e kthejnë fokusin te ndeshja e radhës, ku të enjten do të përballen me Izraelin në Debrecen të Hungarisë, ndërsa më pas, më 4 tetor, e pret Austrinë në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë.

RAHMANI DHE NAPOLI ME MARRËVESHJE PËR RINOVIMIN E KONTRATËS



NAPOLI, 28 SHTATOR - Napoli ka arritur marrëveshje me Amir Rrahmanin për rinovimin e kontratës, ndërsa ka mbetur vetëm konfirmimi zyrtar i vazhdimit të bashkëpunimit mes palëve. Është bërë me dije se mbrojtësi nga Kosova është pajtuar me kushtet e ofruara nga presidenti i Napolit, Aurelio De Laurentiis, duke pranuar ta vazhdojë kontratën aktuale, e cila i

skadon vitin e ardhshëm, edhe për dy vjet të tjera. Me rinovimin e kontratës, Rrahmani do të jetë pjesë e skuadrës së Napolit deri në verën e vitit 2029, ndërsa do të ketë një pagë vjetore prej 3.8 milionë eurosh në sezon. Ky veprim është një sinjal i qartë se Rrahmani bën pjesë në planet e ekipit nga Seria A, me të cilin ka fituar dy tituj të kampionit të Italisë.

Rrahmani i është bashkuar Napolit në vitin 2020, ndërsa edhe këtë sezon vazhdon të jetë një prej lojtarëve më të rëndësishëm të ekipit, duke regjistruar 540 minuta lojë në të gjitha garat. Po ashtu, kjo marrëveshje vjen si përgjigje ndaj spekulimeve të fundit se Rrahmani mund të transferohej në Angli, Turqi apo Arabinë Saudite, pasi kishte pasur interesim për shërbimet e tij.

Driton Kuka veçon sukseset e gjeneratës së re, por ngre shqetësime për obligimet ndaj federatës


PEJË, 28 SHTATOR - Trajneri i njohur i xhudos, Driton Kuka, e ka nisur javën me një mesazh ku ka veçuar sukseset e gjeneratës së re të xhudos së Kosovës, njëkohësisht ka ngritur shqetësime për problemet që, sipas tij, vazhdojnë të mbeten pa zgjidhje. Kuka ka publikuar një fotografi

nga Ballkaniku U23, i mbajtur në Pejë, ku Kosova ka pasur paraqitje dominuese në konkurrencën me 10 shtete pjesëmarrëse. “Për një javë të mbarë... Me foton nga Ballkaniku U23 i mbajtur në Pejë ku Kosova dominoi në një konkurrencë prej 10 shteteve pjesëmarrëse ju

urojmë fillim të mbarë të javës. Gjenerata e re po del në sipërfaqe duke treguar që ndërrimi i gjeneratave po ndodh me sukses!”, ka shkruar Kuka në “Facebook”. Megjithatë, Kuka më pas ka ngritur edhe çështjen e përmbytjes së obligimeve ndaj federatës, duke shprehur

pakënaqësi për problemet që, sipas tij, vazhdojnë. “Në anën tjetër... Po hyjmë në tremujorin e fundit për pak ditë, por problemet me TM, fjala është në kryerje të obligimeve për federatën, s’po ndalen aspak! Për më tepër, as përgjigje çka po ndodh s’kemi!”, ka shkruar Kuka.





N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail..contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com



Në bazë të dispozitave të nenit 21, pikës 21.4 të Ligjit nr. 03/L- 087 Për Ndërmarrjet Publike, gjegjësisht nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 17 të Statutit, Bordi i Drejtorëve i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A., me datë 11.09.2026 bazuar mbi Vendimin Nr. 1/2058 publikon këtë:

KONKURS PUBLIK
Për plotësimin e një (1) pozite

1. Titulli i punës: Këshilltar/e i/e Përgjithshëm – Sekretar/e Korporativ/e
Vendi: Prishtinë.
Ndërmarrja: N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë.
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve.
Mandati: 3 vite
Koeficienti: 5.9

2. Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:
Bordi i Drejtorëve, dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) (iii) nuk janë, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) muajsh para datës së aplikimit nuk kanë qenë Drejtorë të Bordit të kompanisë gjegjëse dhe (iv) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë; Çdo person i cili dëshiron të merret parasysh për një pozitë të drejtorit duhet që po ashtu t’i përmbushë edhe kushtet e përshtatshmërisë profesionale në vijim:

- Të posedojë diplomë universitare -Fakulteti Juridik (jurist i diplomuar ose master në shkenca juridike);
- Të posedojë së paku pesë (5) vite përvojë profesionale nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtës së shoqërive tregtare;
- Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 si dhe të plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d),(f),(j),(k),(l) të Ligjit nr. 03/L -087 të Ndërmarrjeve Publike dhe Plotësim Ndryshimit të LNP nr. 04/L-111 neni 13;
- Aftësi për punë ekipore;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese;
- Të ketë etikë në punë dhe integritet.
- Të posedojë njohuri të punës me kompjuter;
- Njohja e gjuhës angleze (e dëshirueshme);
- Dëshmitë mbi njohuritë dhe të arriturat tjera do të mirren në konsideratë dhe vlerësohen konform relevancës me vendin e punës;
- Të jetë person me integritet të lartë dhe të plotësojë të gjitha kushtet e përshtatshmërisë të parapara me neni 17 të Ligjit të Ndërmarrjet publike nr. 03/L-087 , dhe plotësim ndryshimet përkatëse,Ligji për Parandalimin e konfliktit të interes në ushtrimin e funksionit public nr/06L-011, si dhe me normat tjera positive relevante.

3. Këshilltar/e i/e Përgjithshëm – Sekretar/e Korporativ/e ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Sigurohet që të përcillen procedurat e Bordit, ku bëjnë pjesë organizimi i takimeve të Bordit, Komiteteve të Bordit dhe Aksionarëve duke përfshirë (në bashkëpunim me Kryesuesin) përgatitjen dhe shpërndarjen e agjendave;
- Mban regjistrin e aksionarëve;
- Koordinon me KE përgatitjen e materialit për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
- Mban procesverbalin e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesit e tyre) dhe i regjistron në librat e protokolleve;
- Shpërndan procesverbalet tek drejtorët dhe aksionarët;
- Merret me regjistrimin zyrtar të ndryshimeve të cilat kërkohen sipas ligjit, i regjistron në regjistrin e Kosovës për shoqëritë tregtare dhe emrat tregtarë;
- Sipas udhëzimeve nga Kryesuesi, përgjegjësitë e Sekretarit përfshijnë sigurimin e rrjedhjes së mirë të informatave brenda Bordit dhe komiteteve të tij dhe në mes të Bordit dhe menaxherëve të lartë të Ndërmarrjes;
- Këshillat dhe shërbimet e Sekretarit duhet të jenë në dispozicion të të gjithë drejtorëve i cili njëheri është përgjegjës tek Bordi për të siguruar që përputhen procedurat e Bordit;
- Përcjell ndryshimet ligjore që kanë të bëjnë me ndërmarrjen duke informuar Bordin dhe menaxhmentin e kompanisë për ndryshimet si dhe për gatitë udhëzimet e nevojshme për menaxhmentin e kompanisë.Merret edhe me çështjet tjera të qeverisjes korporative sipas nevojës.

4. Informatë për procedurën e konkurimit

- Kandidatët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:
- Formulari i kërkesës për punësim (aplikimit);
- Kopje e letërnjoftimit; CV ; Çertifikata e lindjes;Letër motivimi;
- Dëshmitë mbi Shkollimin dhe kualifikimin profesional e noterizuar;
- Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe e noterizuar.
- Dëshmi për përvojën e punës/vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
- Pasqyrat e kontributeve pensionale (nuk kërkohet për përvoja të punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë institucion);
- Deklarata nën betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2 të Ligjit të NP e cila mundë të shkarkohet nga uebfaqja e Kompanisë;
- Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i dënuar për kryerjen e ndonjë vepre penale (jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit);
- Lista e dokumenteve të dorëzuara.

5. Afati i Konkursit:

Konkursi publik është i hapur në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data 11.09.2026 deri më 10.10.2026

Të interesuarit mund t’i dorëzojnë kërkesat (aplikacionet) e tyre me dokumentet tjera relevante në emailin: burimetnjerezore@pallatirinise.com

Formulari për kërkesë (aplikim) dhe Deklarata nën betim, mund të shkarkohen nga web-faqja e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë në <http://www.pallatirinise.com/> ose mund të merren në zyrat e Ndërmarrjes.

6. Vërejtje:

Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe jo-adekuat dhe jashtë afatit të konkurrimit, do të refuzohen.
Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe përfshihen në listën e ngushtë.

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “TIBET SOFTWARE” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812370021dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “TIBET SOFTWARE” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812370021 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “TIBET SOFTWARE” L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 812370021the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail..contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Na osnovu odredbi člana 21, tačke 21.4 Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, odnosno člana 13 Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i na osnovu člana 17 Statuta, Upravni odbor N.P.L. PALATI I RINISE AD, od 11.09.2026. godine, na osnovu Odluke Br. 1/2058 objavljuje ovo:

JAVNI KONKURS

Za popunjavanje jedne (1) pozicije

1. Naziv radnog mesta: Generalni savetnik - Sekretar preduzeća
Lokacija: Priština.

Preduzeće: N.P.L. PALATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini.

Odgovoran: Upravnom odboru.

Mandat: 3 godine

Koeficijent: 5.9

2. Generalni savetnik - Sekretar preduzeća ima sledeće dužnosti i odgovornosti: Upravni odbor želi da osigura da svi potencijalni kandidati budu osobe visokog integriteta koje ispunjavaju kvalifikacione uslove iz člana 17.1, (ii) ispunjavaju kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k) i (l) (iii) nisu, ili u bilo kom trenutku tokom trideset šest (36) meseci pre datuma podnošenja zahteva nisu bili, direktori Upravnog odbora relevantne kompanije i (iv) imaju neophodno stručno iskustvo i obrazovanje potrebno za predmetnu poziciju; Svako lice koje želi da bude razmatrano za poziciju direktora mora takode ispunjavati sledeće uslove stručne podobnosti:

- Posedovati univerzitetsku diplomu - Pravni fakultet (diplomirani pravnik ili master pravnih nauka);

- Posedovati najmanje pet (5) godina stručnog iskustva u oblasti korporativnog upravljanja ili kompanijskog prava;

- Ispunjavati kvalifikacione uslove iz člana 17.1 i ispunjavati kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k), (l) Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i izmene ZJP br. 04/L-111, član 13;

- Sposobnost za timski rad;
- Posedovati dobre komunikacijske veštine;
- Posedovati radnu etiku i integritet.
- Posedovati računarske veštine;
- Znanje engleskog jezika (poželjno);
- Dokazi o drugim znanjima i dostignućima biće uzeti u obzir i procenjeni u skladu sa relevantnošću za posao;
- Biti osoba sa visokim integritetom i ispunjavati sve uslove podobnosti utvrđene članom 17 Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087 i relevantnim izmenama, Zakonom o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javnih funkcija br. 06/L-011, kao i drugim relevantnim pozitivnim normama.

3. Generalni savetnik – Sekretar kompanije ima sledeće dužnosti i odgovornosti:

- Osigurati da se poštuju procedure Odbora, uključujući organizaciju sastanaka Odbora, odbora Odbora i akcionara, uključujući (u saradnji sa predsednikom) pripremu i distribuciju dnevnog reda;
- Voditi registar akcionara;
- Koordinirati sa Izvršnom komisijom pripremu materijala za sastanke Odbora direktora;
- Voditi zapisnike sa sastanaka Odbora direktora i Odbora za reviziju (osim ako njihovi predsednici ne zahtevaju drugačije) i evidentirati ih u zapisnicima;
- Distribuirati zapisnike direktorima i akcionarima;
- Obavljati zvaničnu registraciju promena koje zahteva zakon, evidentirajući ih u Kosovskom registru trgovačkih društava i trgovačkih imena;
- Prema uputstvima predsednika, odgovornosti Sekretara uključuju obezbeđivanje nesmetanog protoka informacija unutar Odbora i njegovih odbora i između Odbora i višeg menadžmenta Kompanije;
- Saveti i usluge Sekretara biće dostupni svim direktorima i biće odgovoran Odboru za obezbeđivanje usklađenosti sa procedurama Odbora;
- Prati pravne promene koje se odnose na Društvo tako što obaveštava Upravni odbor i rukovodstvo Društva o promenama i priprema neophodna uputstva za rukovodstvo Društva. Takođe se bavi i drugim pitanjima korporativnog upravljanja po potrebi.

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/ potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/ potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;
- Izjave o penzijskim doprinosima (nisu potrebne za radna iskustva pre osnivanja Kosovskog fonda za penzijsku štednju, i za ona iskustva kada poslodavci nisu bili u obavezi da plaćaju ovoj instituciji);
- Izjava pod zakletvom u skladu sa članovima 17.1 i 17.2 Zakona o JP koja se može preuzeti sa veb stranice Kompanije;
- Potvrda nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da lice nije osuđivano za bilo koje krivično delo (ne starija od 6 (šest) meseci od datuma izdavanja);
- Spisak podnetih dokumenata.

5. Rok za konkurs:

Javni konkurs je otvoren u periodu od 30 (trideset) dana od 11.09.2026 do 10.10.2026. Zainteresovana lica mogu podneti svoje prijave sa ostalom relevantnom dokumentacijom na imejl adresu: burimetnjerezore@pallatirinise.com Obrazac za prijavu i izjava pod zakletvom mogu se preuzeti sa veb stranice N.P.L. PALATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini na <http://www.pallatirinise.com/> ili se mogu dobiti u kancelarijama Kompanije.

6. Napomena:

Kandidati sa nepotpunom, nekompletnom i neadekvatnom dokumentacijom i van roka za konkurs biće odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju navedene kriterijume i koji su uvršteni u uži izbor.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Lisi Group” SH.P.K. me numër Unik Identifikues: 810845167 bënë ulje të kapitalit nga 140,000.00 në 1000.
- Trim Rezniqui shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.
- Vjosa (Jusuf) Gradinaj, shpall të pavlefshme certifikatën e dhënies së Provimit të Jurisprudencës, me nr. 91/2017, të lëshuar në Prishtinë më 13.03.2017, për provimin e jurispru-dencës të dhënë më 31.01.2017, nga Ministria e Drejtësisë.
- Vjosa Jusuf Gradinaj shpall të pavlefshme diplomën LL.M. (Master) në Kontrata dhe të Drejtën Komerciale, në emër të, nr. 1689, të lëshuar më 27.02.2018, nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” – Fakulteti Juridik.
- “Master Build SRL Dega në Kosovë” shpall të pavlefshme certifikatën e biz-nesit me nr. Unik Identifikues: 811932583.
- Thot Ratkoceri shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme “28 Nëntori” shkolla Teknike Prishtinë.
- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “ Abdyl Frasheri “ Prizren.
- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K “11 Marsi “ Prizren.
- Trim Rezniqui shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p “Gjon N. Kazazi” Gjakovë.
- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.
- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.
- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Sebastjan Prenka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shf.f.m.u “Ahmet Rrustemi” Bec Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Diana Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Albana Gjocaj nga Juniku shpall të pavlefshme diplomën e universiteti Publik “Fehmi Agani” Gjakovë, drejtimi Infermieri, Bachelor me nr. 104.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS
IAAP "LASGUSH PORADECI" KIJEVË

Date: 28/09, 2026
Nr. Prot: 1/165-26

IAAP "Lasgush Poradeci" Kijevë
Adresa: Rruga "Imer Krasniqi" pn.
shmplasgushporadeci@gmail.com

Bazuar në UA NR. 02/2016 të MASHT, për aktivitetet jashtëshkollore, IAAP "Lasgush Poradeci" në Kijevë shpallë:

ofertë për ekskursion
(Ekskursion 5 ditor jashtë vendit - Shqipëri)

IAAP "Lasgush Poradeci" në Kijevë shpallë ftesë për oferta për përzgjedhjen e agjensionit të udhëtimit dhe akomodimit për organizimin e Ekskursionit 5 ditor në Republikën e Shqipërisë me maturantët për vitin shikollor 2026/27

Kohëzgjatja e ekskursionit do të jetë 4 netë / 5 ditë, me pension të plotë.

Agjensioni turistik duhet ti plotësojë këto parakushte:

1. Kompania (agjensioni) turistik duhet të jetë i licensuar,
2. Të ketë fletëdëshminë e kontrollës teknike të autobusëve sipas procedurave ligjore,
3. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e nxënësve,
4. Kompania (agjensioni) turistik duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendorë të ngasësve të autobusëve,
5. Kompania (agjensioni) turistik duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe të ketë dëshmitë (cërtifikatë pune dhe diplomë të mjeksisë) që i shoqëron nxënësit,
6. Kompania (agjensioni) turistik duhet të ketë dokumentacionin (licensën) e akreditimit të ushqimeve në Shqipëri të nënshkruar dhe të vulosur nga pronari i hotelit,
7. Kontrata në mes të hotelit dhe Kompanis (agjensionit) turistik,
8. Kompania (agjensioni) turistik duhet të prezantojë menynë ditore të ushqimit për secilën ditë të qëndrimit në Shqipëri të nënshkruar dhe të vërtetuar nga pronari i hotelit,
9. Një fletë konfirmim të rezervimit të hotelit përkatës të vërtetuar në mes të kompanisë turistike dhe hotelit me datë të caktuar,
10. Licenca e ballos e vulosur dhe nënshkruar nga pronari i hotelit, ku nxënësit do të argëtohen,
11. Vërtetim i ATK-së,
12. Hoteli ku bëhet akomodimi i nxënësve duhet të ketë shërbimin e sigurimit fizik dhe profesional,
13. Agjensioni duhet ti mbulojë shpenzimet e vizitave të nxënësve në monumente historike,
14. Të kihet parasysh numri i nxënësve të vendosur nëpër dhoma.

Kategorizimi do të bëhet në bazë të kriterëve dhe sigurisë ku dhe do të vendoset për ofertën dhe vendin (hotelin) e vendosjes së nxënësve, nga komisioni përkatës ditën e hapjes së ofertave.

VËREJTJE: OFERTAT TË CILAT NUK I PËRMBUSHIN KRITERET E KËRKUARA NUK DO TË MERREN NË SHQYRTIM.

- Afati i aplikimit është 7 ditë nga dita e shpalljes së ofertës,
- Ofertat pranohen në sportelet e DKAE – së në komunën e Malishevës,
- Hapja e ofertave do të bëhet në ditën e fundit të aplikimit duke filluar nga ora 14:00 në shkollë.

Kijevë: 28/09/2026

Udhëdrejtori. Msc. Burim Gashi

KIJEVË
MALISHEVË
LASGUSH PORADECI

 **Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

 **Lume's Details**

Estetik & Depilim



 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Abirapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

